

Ardian DINE

Eduart VELCANI



REPUBLIKA E SHQIPERISE
KESHILLI KOMBETAR I UJIT
KESHILLI I BASENIT UJEMBLEDHES "VJOSE", VLORE

VENDIM

Nr. 3, Dt. 17.10.2011

Per mos miratim te Rinovimit te Lejes, per shfrytezim inertesh ne shtratin e lumit Pavllo, ne nje mjedis teresisht lumor, ne afersi te fshatit Shales, (ne jugeperendim te tij), subjektit "Elmazi Bogaz" sh.p.k, Komuna Markat, Sarande, Qarku Vlore.

Ne zbatim te kerkesave qe percakton Ligji Nr.8093 Dt. 21/03/1996 "Per Rezervat Ujore", konkretisht, neni 8 dhe 20, vendimit nr. 1, nr.2 dhe nr. 3, dt.21.06.2006, te K.K.U-se, si dhe vendimit nr.1 dhe nr.2 dt. 07.06.2007 te K.K.U-se, duke gjykuar mbi kerkesen dhe studimin e paraqitur nga subjekti "Elmazi Bogaz" sh.p.k, Komuna Markat, Sarande, Qarku Vlore, me administrator Fitimtar Elmazi, Keshilli i Basenit Ujembledhes "Vjose",

VENDOSI:

- 1- Te mos miratoj Rinovimin e lejes, per shfrytezim inertesh ne shtratin e lumit Pavllo, ne afersi te fshatit Shales, (ne jugperendim te tij), Komuna Markat, Sarande, Qarku Vlore, subjektit "Elmazi Bogaz", me Administrator Fitimtar Elmazi, Sarande, me qellim plotesimin e planit te rehabilitimit te lumit sipas formularit F.
- 2- Plani i rehabilitimit, i plotesuar sipas kerkesave te formularit, te paraqitet prane A.U.B Vjose, brenda muajit qe vijone.
- 3- Ngarkohet A.U.B "Vjose" per zbatimin e ketij vendimi.
- 4- Ky vendim hyne ne fuqi menjehere.

PERGJEGJES I A.U.B "VJOSE"

Ardian DINE



KRYETAR I K.B.U "VJOSE"

Eduart VELCANI

